



**KUVENDI I SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**

*Tiranë më, 04.11.2021*

*Dokument parlamentar*

**RAPORT**

**PËR**

**PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”**  
*(Shqyrtim në parim)*

● **HYRJE**

Komisioni për Politikën e Jashtme, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, në mbledhjen e datës 03 Nëntor 2021.

Relator për këtë projektligj ishte deputeti Z. Etjen Xhafaj.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit ishin të pranishëm: Znj. Olta Xhaçka, Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Armand Skapi, Sekretar i Përgjithshëm i MEPJ, Znj. Ilda Dega, Drejtoreshë e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Z. Sokol Dedja, Drejtor Përgjithshëm i Çështjeve Politike dhe Strategjike e të ftuar të tjerë.

**I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2022” është nismë e Këshillit të Ministrave, mbështetur në nenet 78, 83 pika 1 dhe 100 të Kushtetutës dhe në nenin 30 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektit procedural, duke qenë se Komisioni për Politikën e Jashtme nuk është komision përgjegjës, ky komision e shqyrton këtë projektligj sipas fushave të tij të përgjegjësisë. Në seancat e zhvilluara komisioni shqyrtoi në parim projekt-buxhetin e parashikuar Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme.

**II. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTLIGJIT**

**2.1** Projektbuxheti 2022 synon konsolidimin e rimëkëmbjes ekonomike të vendit pas dy fatkeqësive natyrore, si tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID-19. Njëkohësisht, nëpërmjet politikave fiskale të kujdesshme që do të ndërmerren si nga krahu i të ardhurave dhe atyre të

shpenzimeve 2 buxhetore, synohet të sigurohet një ulje e pandalshme dhe e qëndrueshme e stokut të borxhit publik në periudhën afatmesme 2022-2024.

**2.2** Projekt buxheti i MEPJ për vitin 2022 është pjesë e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024. Hartimi i projektbuxhetit të MEPJ është përgatitur në funksion të aktivitetit diplomatik dhe konsullor të MEPJ, përfshirë këtu edhe misionet diplomatike dhe postet konsullore jashtë vendit. Planifikimi ka në themel objektivat e përcaktuara të Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim si dhe Planin Kombëtar të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian. Për vitin 2022 projektbuxheti mundëson vazhdimin normal të përfaqësimit të Shqipërisë në shtetet ku jemi akredituar, si dhe zbatimin e strategjive, politikave, objektivave të shërbimit të jashtëm.

**2.3** Objektivat kryesorë që synohen të arrihen nga aktiviteti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2022-2024 janë:

- Nisja e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, me Konferencën e parë Ndërqeveritare; avancimi i tyre në bazë të metodologjisë së re të procesit të negocimit me BE-në: Avancimi i zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit BE-Shqipëri;
- Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit të MEPJ dhe përfaqësive diplomatike për procesin e negociatave të anëtarësimit në BE;
- Vijim i komunikimit intensiv me vendet anëtare të KS për të siguruar bashkëpunim sa më të afërt dhe efektiv gjatë periudhës së shërbimit si anëtar jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të OKB;
- Performancë e lartë e strukturave në MEPJ dhe e Misionit të Përhershëm të RSH në OKB me qëllim realizimin e një përfaqësi sa më dinjitoz në KS/OKB;
- Forcimi i marrëdhënieve me vendet e rajonit dhe bashkëpunimit rajonal;
- Konsolidim i marrëdhënieve me Kosovën, përmes G2G, zbatimit të marrëveshjeve të përbashkëta, angazhimit për njohjen e mëtejshme ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, etj.;
- Forcimi i kohezionit të shqiptarëve në rajon;
- Zhvillim i mëtejshëm i marrëdhënieve me vendet e tjera, me prioritet marrëdhëniet me partneret strategjik, vendet mike dhe aleate;
- Pjesëmarrje aktive në nismat e bashkëpunimit rajonal, përfshirë Kryesimi i Nismës Adriatiko-Joniane / EUSAIR;
- Pjesëmarrje aktive dhe realizimi i kontributit të RSH në kuadër të NATO-s;
- Zbatimi i detyrimeve të anëtarësimit në organizata dhe forume shumëpalëshe, ku jemi palë;
- Forcimi dhe rritja e rolit të diplomacisë publike, ekonomike dhe diasporës, në shërbim të interesave ekonomike të Shqipërisë, promovimit dhe potencialeve për investime, tregti dhe bashkëpunimit ekonomik, tregtar dhe kulturor me partnerët tanë ndërkombëtar dy dhe shumëpalësh; thithja e investimeve të huaja në Shqipëri dhe përmirësimi i imazhit të vendit përmes zhvillimit të diplomacisë ekonomike dhe publike;
- Realizim i një shërbimi konsullor të mbështetur në profesionalizëm, efikasitet, transparencë dhe përgjegjshmëri, përmes dixhitalizimit të shërbimeve konsullore, hapjes së konsullatave të reja.

### III. DISKUTIMET NË KOMISION

#### • PROJEKT-BUXHETI PËR MINISTRINË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Znj. Mimi Kodheli, Kryetare e Komisionit, fillimisht ia dha fjalën Znj. Olta Xhaçka, Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ministria, bëri një pasqyrë të gjerë e të detajuar të aktivitetit të MEPJ. Në fjalën e saj theksoj se projektbuxheti i MEPJ shënon një rritje të konsiderueshme prej 17%, krahasuar me atë të vitit 2021. Sipas saj kjo do të mundësojë plotësimin e kapaciteteve njerëzore për përballimin me sukses të anëtarësimit në Këshillin e Sigurimit të OKB. “Projekt-buxheti i vitit 2022 ka si synim të tij madhor përmbushjen e objektivave të Programit të Qeverisë, të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe të Planit Kombëtar të Integrit Evropian.

Projekt buxheti për vitin 2022, do të lehtësojë realizimin e prioriteteve të rëndësishme si: zhvillimi i Konferencës së parë Ndërqeveritare për anëtarësimin e Shqipërisë në BE apo zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit mes Shqipërisë dhe BE-së etj. Mandati në Këshillin e Sigurimit, përfaqëson një sfidë madhore por edhe një mundësi të shkëlqyer. Me rëndësi të pandryshuar mbetet për ne objektivi i forcimit të marrëdhënieve me vendet e rajonit”.

Për vitin 2022, agjenda për diasporën do të përfshihet në fushën e veprimit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Si rrjedhojë, në strukturën e përgjithshme të MEPJ do të shtohen strukturat e posaçme, që janë marrë me hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e diasporës.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të operojë me 4 (katër) Programe Buxhetore si më poshtë:

1. Planifikimi, menaxhimi dhe Administrimi;
2. Mbështetje Diplomatike Jashtë Shtetit;
3. Aktiviteti Diplomatik dhe Konsullor i MEPJ;
4. Mbështetja Institucionale për Procesin e Integrit.

*Tabela 1.*

<b>1</b>	<b>Ministria e Evropes dhe Puneve te Jashtme</b>	<b>2,970,363</b>	<b>91,000</b>	<b>80,780</b>	<b>171,780</b>	<b>3,142,143</b>
2	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	268,756	55,000	0	55,000	323,756
3	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,391,927	15,000	0	15,000	2,406,927
4	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	204,440	0	0	0	204,440
5	Mbeshtetja Institucionale për Procesin e Integrit	105,240	21,000	80,780	101,780	207,020

*\*Burimi (Të dhëna i referohen relacionit shoqërues të Projektbuxhetit të Vitit 2022).*

Totali i buxhetit vjetor për Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) sipas projektbuxhetit të vitit 2022 është parashikuar **3,142,143,000** (Tre miliardë e njëtëqind e dyzet e dy milionë e njëtëqind e dyzet e tre) Lekë.

Në cilësinë e relatorit Z. Etjen Xhafaj u shpreh se projektbuxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në parim i plotëson nevojat në lidhje me detyrat e objektivat për vitin 2022. Parashikimi i buxhetit nevojitet të synojë rritjen e pranisë tonë në kontinentin afrikan, rritjen e punës me Kosovën, me diasporën si dhe për rritjen e imazhit, punës në shërbimet konsullore etj. Në përfundim ai ftoi Komisionin ta miratojë atë.

Pas prezantimit, deputetët kërkuan sqarime rreth planifikimit buxhetor për këtë ministri dhe shprehën vlerësimet dhe sugjerimet e tyre që planifikimi të mbështesë nevojat për përmbushjen optimale dhe efektive të objektivave të politikës së jashtme.

Znj. Mimi Kodheli, në përfundim të diskutimeve, falënderoi të gjithë kolegët për kontributin e tyre të çmuar dhe ftoi Komisionin për të votuar projektligjin.

#### **IV. PËRFUNDIME**

Në aspektin **ligjor**, projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës.

Në aspektin **procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin **formal**, projektligji përbëhet nga 3 Krerë dhe 22 Nene.

Në përfundim, deputetët e komisionit, pasi u njohën me projektbuxhetin e vitit 2022 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme në përfundim të diskutimeve, **miratuan në parim me shumicë votash projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”.**

**RELATOR**  
**ETJEN XHAFAJ**

**KRYETARE**  
**MIMI KODHELI**



**KUVENDI I SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**  
*Dokument parlamentar*

**RAPORT**

**PËR**

**PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”**  
*(Shqyrtim nen për nen)*

● **HYRJE**

Komisioni për Politikën e Jashtme, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”.

Relator për këtë projektligj ishte deputeti Z. Etjen Xhafaj.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit ishin të pranishëm Z. Armand Skapi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Znj. Ilda Dega, Drejtoreshë e Përgjithshme Ekonomike në MEPJ dhe e Shërbimeve Mbështetëse e të ftuar të tjerë nga Ministria për Ekonominë dhe Financat.

**V. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2022” është nismë e Këshillit të Ministrave, mbështetur në nenet 78, 83 pika 1 dhe 100 të Kushtetutës dhe në nenin 30 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektit procedural, duke qenë se Komisioni për Politikën e Jashtme nuk është komision përgjegjës, ky komision e shqyrton këtë projektligj sipas fushave të tij të përgjegjësisë. Në seancën paraardhëse komisioni shqyrtoi në parim projekt-buxhetin e parashikuar Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme.

**VI. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTLIGJIT**

Projektbuxheti 2022 synon konsolidimin e rimëkëmbjes ekonomike të vendit pas dy fatkeqësive natyrore, si tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID-19. Njëkohësisht, nëpërmjet politikave fiskale të kujdesshme që do të ndërmerren si nga krahu i të ardhurave dhe atyre të

shpenzimeve 2 buxhetore, synohet të sigurohet një ulje e pandalshme dhe e qëndrueshme e stokut të borxhit publik në periudhën afatmesme 2022-2024.

Projekt buxheti i MEPJ për vitin 2022 është pjesë e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024. Hartimi i projektbuxhetit të MEPJ është përgatitur në funksion të aktivitetit diplomatik dhe konsullor të MEPJ, përfshirë këtu edhe misionet diplomatike dhe postet konsullore jashtë vendit. Planifikimi ka në themel objektivat e përcaktuara të Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim si dhe Planin Kombëtar të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian. Për vitin 2022 projektbuxheti mundëson vazhdimin normal të përfaqësimit të Shqipërisë në shtetet ku jemi akredituar, si dhe zbatimin e strategjive, politikave, objektivave të shërbimit të jashtëm.

• **PROJEKT-BUXHETI PËR MINISTRINË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**

Totali i buxhetit vjetor për Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) sipas projektbuxhetit të vitit 2022 është parashikuar **3,142,143,000** (tre miliardë e njëtëqind e dyzet e dy milionë e njëtëqind e dyzet e tre) Lekë.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të operojë me 4 (katër) Programe Buxhetore si më poshtë:

5. Planifikimi, menaxhimi dhe Administrimi;
6. Mbështetje Diplomatike Jashtë Shtetit;
7. Aktiviteti Diplomatik dhe Konsullor i MEPJ;
8. Mbështetja Institucionale për Procesin e Integritimit.

1	Ministria e Evropes dhe Puneve te Jashtme	2,970,363	91,000	80,780	171,780	3,142,143
2	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	268,756	55,000	0	55,000	323,756
3	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,391,927	15,000	0	15,000	2,406,927
4	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	204,440	0	0	0	204,440
5	Mbeshtetja Institucionale për Procesin e Integritimit	105,240	21,000	80,780	101,780	207,020

*\*Burimi (Të dhëna i referohen relacionit shoqërues të Projektbuxhetit të Vitit 2022).*

Orientuar nga prioritetet e politikës së jashtme, projektbuxheti i vitit 2022 mundëson kapacitetet e domosdoshme të mbështetjes financiare për realizimin e objektivave si:

- Nisja e negociatave për anëtarësimin në BE. Zhvillimi i kapaciteteve profesionale te stafit te MEPJ dhe përfaqësive diplomatike për procesin e negociatave të anëtarësimin në BE.
- Vijimi i komunikimit intensiv me vendet anëtare të KS për të siguruar bashkëpunim sa më të afërt dhe efektiv gjatë periudhës së shërbimit si anëtar jo i përhershëm i KS të OKB. Performancë e lartë e strukturave në MEPJ dhe e Misionit të Përhershëm të RSH në OKB me qëllim realizimin e një përfaqësimi sa më dinjitoz në KS/OKB
- Forcimi i marrëdhënieve me vendet e rajonit dhe bashkëpunimin rajonal.

- Konsolidimi i marrëdhënieve me Kosovën përmes G2G, zbatimit të marrëveshjeve të përbashkëta, angazhimit për njohjen e mëtejshme ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare.
- Zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me vendet e tjera me prioritet marrëdhëniet me partneret strategjik, vendet mike dhe aleate.
- Forcimi i kohezionit të shqiptarëve në Rajon
- Zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me vendet e tjera, me prioritet marrëdhëniet me partneritet strategjik, vendet mike dhe aleate.
- Përfaqësim dhe pjesëmarrje aktive në organizatat ndërkombëtare e rajonale ku Shqipëria është palë, në forume shumëpalëshe dhe koalicione ndërkombëtare ku ndajmë interesa dhe vlera të përbashkëta në mbështetje dhe mbrojtje të interesave të vendit dhe atyre kombëtarë.
- Forcimi dhe rritja e rolit të diplomacisë publike ekonomike dhe diasporës në shërbim të interesave ekonomike të Shqipërisë, promovimit dhe potencialeve për investime, tregti dhe bashkëpunim ekonomik, tregtar dhe kulturor me partneret tanë ndërkombëtare, dypalësh dhe shumëpalësh, thithja e investimeve të huaja në Shqipëri dhe përmirësimi i imazhit të vendit përmes zhvillimit të diplomacisë ekonomike dhe publike.
- Realizimi i një shërbimi konsullor të mbështetur në profesionalizëm eficient, transparencë dhe përgjegjshmëri përmes dixhitalizimit të shërbimeve konsullore dhe hapjes së konsullatave të reja.

Krahasuar me buxhetin e vitit 2021, projektbuxheti për vitin 2022 rezulton me rritje 466,487,000 lekë ose 17%.

Rritja e buxhetit të vitit 2022 sipas projektbuxhetit konsiston në:

1. Financimin e politikave të reja në masën 250,000,000 lekë (Dyqind e pesëdhjetë milionë lekë), konkretisht për Këshillin e Sigurimit.
2. Financimin e programit “Shërbime për diasporën” 202,036,000 lekë (dyqind e dy milionë e tridhjetë e gjashtë mijë) - *ky është buxheti i ish-Ministrit të Diasporës të cilin qeveria e ka përfshirë në buxhetin e MEPJ.*

Programi “Shërbime për diasporën”, përfshin 4 agjenci:

- Agjencia për diasporën
- Qendra e botimeve për diasporën
- Fondi i Zhvillimit për diasporën
- Qendra e studimeve dhe publikimeve për arbëreshët

Sipas draftit të Projekt Buxhetit, paraqiten tabelat e mëposhtme:

Tab. 1

BUXHETI	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Buxheti vjetor
Projektbuxheti 2022	2,970,363,000	171,780,000	3,142,143,000
Buxheti 2021	2,551,876,000	123,780,000	2,675,656,000
Rritja:	418,487,000	48,000,000	466,487,000

Tab. 2

Referuar programeve buxhetore, rritja e buxhetit të MEPJ sipas projektbuxhetit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Programet buxhetore të MEPJ	Buxheti 2021	Projektbuxheti 2022	Rritje sipas programeve buxhetore
01110 "Planifikim menaxhim Administrim"	139,600,000	323,756,000	184,156,000
01120 "Mbështetje diplomatike jashtë vendit"	2,138,776,000	2,406,927,000	268,151,000
01130 "Aktiviteti diplomatik dhe konsullor I MEPJ"	195,500,000	204,440,000	8,940,000
01150 " Mbështetje institucionale për procesin e integrimin"	201,780,000	207,020,000	5,240,000
<b>Totali i buxhetit vjetor:</b>	<b>2,675,656,000</b>	<b>3,142,143,000</b>	<b>466,487,000</b>

Tab. 3

Sipas draftit të Projekt Buxhetit buxheti i shpenzimeve kapitale paraqitet në tabelën e mëposhtme:

BUXHETI	Projekte me financim të brendshëm	Projekte me financim të huaj	Buxheti vjetor për shpenzimet kapitale
Projektbuxheti 2022	91,000,000	80,780,000	171,780,000
Buxheti 2021	43,000,000	80,780,000	123,780,000
<b>Rritja:</b>	<b>48,000,000</b>	<b>0</b>	<b>48,000,000</b>

## VII. DISKUTIMET NË KOMISION

Znj. Mimi Kodheli, Kryetare e Komisionit, fillimisht ia dha fjalën të ftuarve nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Z. Armand Skapi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme bëri një prezantim të projektbuxhetit të MEPJ duke theksuar se “Projekt-buxheti i vitit 2022 ka si synim të tij madhor përbushjen e objektivave të Programit të Qeverisë, të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian. Projekt buxheti për vitin 2022, do të lehtësojë realizimin e prioriteteve të rëndësishme si: zhvillimi i Konferencës së parë Ndërqeveritare për anëtarësimin e Shqipërisë në BE apo zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit mes Shqipërisë dhe BE-së etj. Mandati në Këshillin e Sigurimit, përfaqëson një sfidë madhore por edhe një mundësi të shkëlqyer. Me rëndësi të pandryshuar mbetet për ne objektivi i forcimit të marrëdhënieve me vendet e rajonit”.

Ai shënon një rritje të konsiderueshme prej 17%, krahasuar me atë të vitit 2021. Kjo do të mundësojë plotësimin e kapaciteteve njerëzore për përballimin me sukses të anëtarësimit në Këshillin e Sigurimit të OKB. Numri i punonjësve për MEPJ për vitin 2022 do të jetë, punonjës gjithsej 620, nga të cilët 368 punonjës në përfaqësitë diplomatike dhe 252 punonjës në aparatet e MEPJ.



Për vitin 2022, agjenda për diasporën do të përfshihet në fushën e veprimit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Si rrjedhojë, në strukturën e përgjithshme të MEPJ do të shtohen strukturat e posaçme, që janë marrë me hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e diasporës.

Z. Etjen Xhafaj, në cilësinë e relatorit pasi u shpreh se projektbuxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në parim i plotëson nevojat në lidhje me detyrat e objektivat për vitin 2022, vlerësoi nevojën e intensifikimit të punës me diasporën, nevojën e rritjen e imazhit, forcimit të diplomacisë publike dhe ekonomike, zgjerimin e shërbimeve konsullore etj. Në përfundim ai ftoi Komisionin ta miratojë atë.

Pas prezantimit, deputetët shprehën vlerësimet dhe sugjerimet e tyre me qëllim që planifikimi të mbështesë nevojat reale për përmbushjen optimale dhe efektive të objektivave të politikës së jashtme dhe interesave kombëtare.

Znj. Mimi Kodheli, në përfundim të diskutimeve, falënderoi të gjithë kolegët për kontributin e tyre të çmuar dhe ftoi Komisionin për të votuar projektligjin.

## **VIII. PËRFUNDIME**

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal, projektligji përbëhet nga 3 Krerë dhe 22 Nene.

Në përfundim, Komisioni, pas diskutimeve, miratoi nen për nen dhe në tërësi me shumicë votash projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022” për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

**RELATOR**  
**ETJEN XHAFAJ**

**KRYETARE**  
**MIMI KODHELI**